

MËSIMI GJASHTË

Mbjellja e një vizioni

Le të fillomë

Kur Perëndia themelon një vizion, udhëheqja e efektshme është e nevojshme për ta komunikuar qartë dhe në mënyrë praktike atë vizion tek ata që do ta bëjnë realitet me përpjekjet e tyre. Në këtë studim nga Nehemia 2:11-20, Alistair Begg-u shqyrton aspektet e udhëheqjes së Nehemias, të cilat e ndihmuan që ta mbillte vizionin e tij për rindërtimin e murit të Jerusalemit në zemrat e popullit të Perëndisë, madje edhe përballë plogështisë dhe kundërshtimit. Nëse një vizion është dhënë nga Perëndia dhe paraqitet me përvullësi, atëherë Ai do ta mbjellë në zemrat e njerëzve dhe do t'i motivojë ata që të reagojnë.

Shënime

Çlodhja

Motivimi

Vëzhgimi

Nxitja

Informacioni

Zbatimi

SHKRIME KYÇ

“Atëherë u thashë atyre: ‘Ju e shikoni gjendjen e mjeruar në të cilën ndodhemi: Jerusalemi është shkatërruar dhe portat e tij janë konsumuar nga zjarri! Ejani t’i rindërtojmë muret e Jerusalemit, dhe kështu nuk do të jemi më të turpëruar!’. U tregova pastaj atyre si dora bamirëse e Perëndisë tim kishte qenë mbi mua si dhe fjalët që mbreti më kishte thënë. Atëherë ata thanë: ‘Të ngrihemi dhe t’i vihemi ndërtimit!’” (Nehemia 2:17-18)

Kundërshtimi

Afirmimi

Vështrim në thellësi

1. “Çlodhja është pjesë e nevojshme e veprimit të dobishëm. Çlodhja nuk duhet të shpërfilllet, të anashkalohet dhe të refuzohet.”

Nëse dëshiron të jesh i efektshëm në shërbesë dhe ta shmangësh drobitjen, atëherë çlodhja duhet të jetë përparësi. Vlerësoji modelet e tua të punës dhe të çlodhjes. A tregohesh i qëllimshëm për të marrë kohë pushimi? Si mund t’i ruash kohët e tua të çlodhjes?

2. *“E vetmja gjë e cila e mban dikë të përkushtuar ndaj detyrës, është që Perëndia na e ka vendosur atë në zemrat tona që ta bëjmë. Kur jemi plot me vizion, plot me shpresë, plot me potencial, dhe përballemi me qëndrimin që thotë: “E provuam më parë, nuk funksionoi; askush nuk është i ngazëlluar; kjo nuk është punë për ne”, atëherë duhet të mbaheni fort, duhet të lidheni pas direkt, duhet të kaloni përmes stuhisë dhe duhet ta mbani mundësinë gjallë.”*

Nëse përpiqesh me guxim që të mbjellësh një vizion biblik në kishën tënde, ka të ngjarë që do të përballesh me zhgënjim dhe kundërshtim. Çfarë mund të bësh kur vjen zhgënjimi, që të sigurohesh se do të këmbëngulësh në mbjelljen e vizionit që Perëndia të ka vendosur në zemër?

3. *“Për çfarë po i besojmë Perëndisë që ai ta bëjë, gjë e cila është aq e pabesueshme, saqë nuk mund të arrihet pa aftësimin e tij hyjnor?”*

Kjo pyetje nga Alistair-i i sfidon pikëpamjet tona të vogla për Perëndinë dhe për atë që Ai është në gjendje të bëjë. Zoti ka premtuar që të gjitha gjërat janë të mundura për Të (Mateu 19:26). Nën dritën e kësaj të vërtete, si do t'i përgjigjeshe pyetjes së Alistair-it?

Mënyra për t'u lutur

- Lutu që Zoti të të japë bindje të palëkundura nga Fjala e Tij, ndaj të cilave ti do të qëndrosh i përkushtuar edhe përballë kundërshtimit.
- Kërkoji Zotit të të veshë me përlulësi, që të kesh mundësi ta trajtosh rezistencën me urtësi dhe hir.
- Mendo për një synim ose një pengesë në shërbesën tënde, e cila aktualisht duket e pamundur. Kërkoji Zotit të ta shtojë besimin, dhe lutu që Ai të bëjë atë që duket e pamundur, për lavdinë e emrit të Tij.